

R A P O R T

P Ë R

VLERËSIMIN E JASHTËM TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT:

*Master Profesional (MP) Administrim Biznesi, dhe
MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike,*

NË INSTITUCIONIN E ARSIMIT TË LARTË JO PUBLIK

“UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË”

Eksperti i Vlerësimit të Jashtëm

Doc. Dr. Arjan QEFALIA

PËRMBAJTJA

- **HYRJE**
- **BAZA LIGJORE E AKTIVITETIT TË GVJ PËR VLERËSIMIN E JASHTËM TË CILËSISË**
- **METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E RVJ**
- **EKSPERTI I VJ**
- **PARIMET E PUNËS PËR VLERËSIMIN E JASHTËM**
- **TË DHËNA PËR PROGRAMIN E STUDIMIT MP ADMINISTRIM BIZNESI DHE MP SHKENCA POLITIKE E ADMINISTRATIVE ME PROFIL ADMINISTRATË PUBLIKE**
- **PLOTËSIMI I STANDARDEVE/KRITEREVE**
 - I. **OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**
 - II. **ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT BËHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**
 - III. **PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA PERSONELI AKADEMIK, PERSONELI NDIHMËS MËSIMORSHKENCOR DHE PERSONELI ADMINISTRATIV**
 - IV. **INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE**
 - V. **INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI**
 - VI. **INSTITUCIONI KA DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE**
 - VII. **INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME**
 - VIII. **INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË**
- **ANALIZA SWOT**
- **REKOMANDIME**

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Hyrje

Institucioni i arsimit të lartë jo publik "Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH)" është një institucion i krijuar në bazë të ligjit nr.9741, dt 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.156, datë 22.03.2001, "Për shkollat jo-publike në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.177, datë 19.02.2009 "Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit Shkolla e lartë private Mesdhetare e Shqipërisë". UMSH_{ja} e ka filluar aktivitetin mësimor të saj gjatë vitit akademik 2009-2010 dhe ofron programe studimi të ciklit të parë në Shkenca ekonomike, Marrëdhënie Ndërkombëtare e Diplomaci, dhe Shkenca Politike; programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkencat ekonomike në profilet: (i) Financë, Bankë, Kontabilitet, (ii) Administrim Biznesi dhe (iii) Biznes dhe Ligj; programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci; programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike në profilet (i) Shkenca Politike dhe (ii) Administratë Publike. Gjithashtu, UMSH_{ja} ofron dhe programe studimi të ciklit të dytë, Master Shkencor (MSc) Financë-Bankë; Master Profesional (MP) Administrim Biznesi; MP Menaxhim Biznesi në profilet: (i) Menaxhim Turizmi dhe (ii) Menaxhim i Pasurisë së Paluajtshme; MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike.

Baza ligjore e aktivitetit për vlerësimin e jashtëm të cilësisë të UMSH_{së} është:

- Ligji nr.9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe akte të tjera nënligjore në mbështetje të tij. Sigurimi i jashtëm i cilësisë, sipas këtyre dispozitave realizohet nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe Akreditimit, i cili kryhet nga Agjensia Publike e Arsimit të Lartë (APAAL).
- Vendimet e Këshillit të Ministrave për hapjen e programeve të studimit pranë UMSH.
- Udhëzimet e MASH_{it} për projektimin e programeve të studimit, për hapjen dhe funksionimin e institucioneve private të arsimit të lartë, për transferimin dhe njohjen e krediteve, për administrimin e dokumentacionit, etj.
- Urdhëri nr.135 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, datë 21.03.2011 "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë të institucioneve të arsimit të lartë".
- Vendimi nr.482, datë 3.10.2011 i MASH "Për hapjen e programeve të ciklit të parë Bachelor, programeve të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave në shkollën e lartë private Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë".
- Udhëzues i APAAL mbi vlerësimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë.
- Aspektet dhe treguesit e vlerësimit të cilësisë në Arsimin e Lartë (APAAL).

Metodologjia për hartimin e raportit

Për hartimin e këtij raporti, vlerësimi i jashtëm është mbështetur në:

- Shqyrtimin dhe analizimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, të hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të UMSH_{së}.

- Shqyrtimin dhe analizimin e dokumentacionit bazë mbi të cilën organizohet e gjithë veprimtaria e zhvillimit të programeve mesimore, të tilla si rregulloret dhe udhëzimet, dosjet e programeve të studimit, regjistrat themeltarë, dokumentacioni i zyrës së burimeve njerëzore, kurrikulave, karrierës dhe financës, si dhe sekretarisë mësimore.
- Vëzhgimet e kryera gjatë vizitës në vend tek UMSH si dhe në intervistimet e stafit drejtues të universitetit, pedagogëve, studentëve dhe stafit administrativ.

Gjatë vizitës në vend u realizuan takime me drejtues të universitetit, të tillë si Dekanin e Fakultetit të Shkencave Politike dhe Administrative, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, drejtuesit e njësive bazë, komitetet shkencore si dhe stafin akademik, studentë, punonjësit e sekretarisë mësimore, të zyrës së kurrikulës, të burimeve njerëzore, të karrierës, të sigurimit të brendshëm të cilësisë etj. Gjithashtu u bë vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij universiteti dhe në bibliotekën e universitetit. Gjatë gjithë procesit të realizimit të vizitave në vend në UMSH, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u asistua dhe nga punonjës pranë Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Angazhimi dhe bashkëpunimi i drejtuesve të UMSH për ofrimin e informacionit të kërkuar ishte mjaft serioz. Pothuajse të gjitha kërkesat e anëtarëve të grupit, lidhur me vënien në dispozicion të dokumentacionit u plotësuan menjëherë, ndërsa në rastet kur informacioni nuk disponohej në moment, si në rastet e të dhënave analitike, ai është ofruar brenda afateve të arsyeshme.

Ky raport konsiston në vlerësimin e jashtëm të programeve të studimit Master Profesional (MP) në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike.

Eksperti i Vlerësimit të Jashtëm:

Doc. Dr. Arjan QEFALIA

Parimet e punës për vlerësimin e jashtëm

- Angazhim serioz dhe bashkëpunim ndërmjet ekspertëve të akreditimit të jashtëm, si dhe me punonjës të APAAL dhe me stafin e UMSH.
- Vlerësimi i mbështetur në dokumenta të paraqitura nga GVB, Institucioni etj.

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional (MP) në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike tek IAL jo publik "Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë".

Programet Master Profesional (MP) në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike kanë filluar regjistrimet e para në muajin nëntor 2011, përkatësisht grupe me 16 dhe 6 studentë, studentë të cilët priten të diplomohen një pjesë në përfundim të vitit 2012 dhe pjesa tjetër në mesin e vitit 2013.

Tabela format për vlerësimin e jashtëm	
të programit të studimit Master Profesional (MP) në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike tek IAL jo publik “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”, mbështetur në Standardet shtetërore për programet e studimit të Ciklit të Dytë	
Standardet/kriteret	Mendimi i GVJ për përmbushjen e standardit/kriterit¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Në bazë të të dhënave dhe informacioneve të siguruar gjatë vizitave që u bënë në institucionin e arsimit të lartë jo publik UMSH, bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe rregulloren e UMSH për masterat profesionale, u konstatua se UMSH ofron programe të studimit Master Profesional (MP) në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), përkatësisht: programin MP në Administrim Biznesi me kohëzgjatje 1.5 vite akademike (neni 17 i rregullores së programeve të studimit MP Administrim Biznesi në UMSH) me kohë të plotë dhe 90 kredite (ECTS), dhe programin MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike me kohëzgjatje 1 vit akademik (neni 17 i rregullores së programeve të studimit MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike në UMSH) me kohë të plotë dhe 60 kredite (ECTS).
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Nga vlerësimet e bëra te UMSH, u konstatua se programi MP në Administrim Biznesi ka kohëzgjatje 1.5 vite akademike (neni 17 i rregullores së programeve të studimit MP Administrim Biznesi në UMSH) me kohë të plotë dhe 90 kredite (ECTS), dhe programi MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike me kohëzgjatje 1 vit akademik (neni 17 i rregullores së programeve të studimit MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike në UMSH) me kohë të plotë dhe 60 kredite (ECTS), pra sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite. Një krediti të studimeve i korrespondojnë 25 orë mësimore pune të studentit.
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Në bazë të të dhënave të siguruar te UMSH lidhur me programet e studimit të ofruara, sëbashku me syllabuset përkatëse, dhe bazuar në RVB, qëllimi i UMSH _{së} është: përgatitja e specialistëve të aftë në sektorin publik, privat dhe atë jofitimprurës, kjo gjë e siguar nga kurrikula bashkëkohore, staf i arsimuar në universitete të njohura brenda dhe jashtë vendit, si dhe ambiente e fasilite bashkëkohore; krijimi i një ambienti kur respektohet dhe vlerësohet çdo person, si dhe duke inspiruar vullnet, arritje dhe perfeksion. Sipas vlerësimit të bërë, programi i studimit Master Profesional (MP) në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike ofrohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e universitetit. Programet e studimeve

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

	<p>në UMSH që janë vlerësuar, janë të organizuara me kohë të plotë dhe me module, të cilat përfundojnë me marrjen e diplomave në fund të 1 viti apo 1.5 viteve (neni 17 i rregullores së programeve të studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike në UMSH). Studentët e diplomuar, në sajë të njohurive të marra gjatë periudhës së studimit, do të mund të orientohen më mirë në tregun e punës sipas profileve përkatëse.</p>
<p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p>	<p>Duke patur parasysh zhvillimet e shumta që kanë ndodhur gjatë dy dekadave të tranzicionit në Shqipëri si në aspektin ekonomik, politik etj, tek UMSH u konstatua (kjo bazuar në programet e studimit dhe syllabuset përkatëse) se ka mbajtur parasysh hartimin e programeve të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës, si për programet MP në Administrim Biznesi me synim formimin e ekspertëve dhe specialistëve të mirë e të aftë për drejtimin e bizneseve të vogla e të mesme, dhe të ndërmarrjeve më të mëdha duke iu siguruar këtyre studentëve formim teorik dhe praktik në fushën e marketingut, menaxhimit strategjik, lidhshirë etj; ashtu edhe për MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike me synim përgatitjen e administratorëve dhe funksionarëve publike të aftë për të kontribuar në zhvillimin përkatës të organizatave publike në Shqipëri.</p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p>	<p>Siç u tha më lart, duke ditur tranzicionin e zgjatur që po përjeton Shqipëria si një vend i vogël në zhvillim, nga UMSH është mbajtur në konsideratë (bazuar në RVB të UMSH dhe diskutimet me drejtues të saj) hartimi i programeve në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojave që imponohen nga ky zhvillim. Për këtë arsye, programet MP Administrim Biznesi janë të orientuara në fushën e administrim biznesit si një nga qëllimet bazë për drejtim të suksesshëm të bizneseve, dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administratë Publike duke konsideruar modernizimin dhe funksionimin sa më eficient dhe efektiv të administratë publike, në mënyrë për të bërë hapa gradualë e pozitivë në funksion të zhvillimit të vendit dhe të bërjes së tij vend i zhvilluar.</p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike janë të hartuara në një mënyrë të tillë që nuk bien ndesh me interesat kombëtare (bazuar në programet përkatëse të studimit dhe syllabuset e lëndëve të MP në fjalë), përkundrazi synimi i tyre është aftësimi i specialistëve të fushave të mësipërme për t'i bërë ballë ndryshimeve të vazhdueshme që po ndodhin sot në Shqipëri e në botë.</p> <p>Këto programe kanë një specifikë sepse marrin në konsideratë jo vetëm kontekstin e Shqipërisë, por dhe kontekstin rajonal, duke marrë parasysh aspektet e zhvillimeve mesdhetare dhe evropiane të tilla si zhvillimet dhe proceset integruese ekonomike, zhvillimet dhe proceset gjeopolitike e kulturore, si dhe marrëdhëniet ndërmjet vendeve të Mesdheut dhe Evropës në kontekstin e proceseve dhe marrëdhënieve globale. Në strategjinë afatgjatë të UMSH theksohet shndërrimi i UMSH në një qendër të fuqishme kërkimore shkencore për të kontribuar në debatin shkencor dhe profesional për çështje që kanë rëndësi të madhe për Shqipërinë dhe Euro-Mesdheun. Gjithashtu, në programet e studimit janë përfshirë edhe lëndët e tilla që adresojnë në mënyrë specifike historinë, proceset, marrëdhëniet, zhvillimet dhe kulturat mesdhetare si edhe gjuhët e vendeve të mesdheut.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin I.1: Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, konstatoj që ai është <i>plotësuar</i> si në aspektin e programeve të studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administrim Publik, të organizuara në module e kredite, duke ruajtur</p>	

numrin mesatar vjetor prej 60 kreditesh ECTS, programe të hartuara në përputhje me qëllimin dhe misionin e UMSH, programe të hartuara në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe të zhvillimit ekonomik të vendit, dhe duke patur si synim mos cënimin dhe ruajtjen e vlerave kulturore të Shqipërisë.

Standardi I.2

- Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit</p>	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike janë përshtatur me strategjinë për zhvillimin e institucionit të arsimit të lartë jo publik UMSH dhe orientimin e tij në çështjet e mesdheut. UMSH synon forcimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin me universitetet të tjera vendase dhe ato të huaja, si dhe me gjithë stakeholdersat të tillë si studentë, qeverinë studentore, prindër, etj. UMSH lëshon diploma në nivel bachelor dhe master shkencor e profesional, si dhe synon dhe studimet e doktoraturës (për ata që mbarojnë Master Shkencor), përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe shndërrimin e UMSH në një qendër të fuqishme të kërkimeve shkencore lokale, rajonale e globale.</p> <p>Programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike synojnë përgatitjen e drejtuesve të biznesit, administratorëve dhe funksionarëve publikë, të aftë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe politik të vendit duke i pajisur studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike. Nga ana e UMSH_{së} synohet përgatitja e studjuesve të mirëfilltë, të pajisur me dije të nevojshme për të integruar kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit, si dhe për të kontribuar me njohuritë dhe eksperiencën e tyre në tregun shqiptar të punës dhe në zhvillimin ekonomik të vendit.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p>	<p>Siç u tha dhe më lart, programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike (bazuar tek RVB_{të} e UMSH dhe planet mësimore përkatëse) synojnë pajisjen studentëve të masterit me njohuri të thelluara teorike dhe praktike në lëndë të tilla si Metoda kërkimi, Strategji të marketingut, Drejtim financiar të avancuar, Drejtim strategjik, Ekonomiks menaxherial, Kontabilitet menaxherial, Sistemet e informacionit të menaxhimit, Strategjitë e komunikimit, Menaxhimi i projekteve, Liderhip, Strategji të biznesit, Njohuri të thelluara për studimin e grupeve dhe institucioneve të shoqërisë, të sistemeve politike, Globalizimi, lëvizjet dhe politikat sociale, Studime të thelluara mbi shkencën dhe të drejtën administrative, Organizimi dhe funksionimi i administratës publike në Shqipëri, Decentralizimi, qeverisja dhe administrata vendore etj, dhe në fund të kursit shoqërohet dhe me praktikën në kompani e biznese private dhe organe të ndryshme të administratës publike, si dhe për ta bërë më të plotë</p>

	<p>këtë kuadër, me përgatitjen e mikrotezës nga studentët master. Programet e ciklit të dytë MP synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë e duhura teorike dhe praktike në fushën e administrim biznesit dhe të administratës publike.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p>	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve (bazuar tek RVB_{te} e UMSH dhe planet mësimore përkatëse). Kjo shihet në lëndët përkatëse të masterit ku vihet theksi tek lëndë të tilla si Metodatat e Kërkimit, Drejtim Financiar i Avancuar, Menaxhim i Avancuar Strategjik, Njohuri të thelluara përsa i përket grupeve, institucioneve të shoqërisë, sistemeve politike e sociale; si dhe e kombinuar me lëndë të reja të cilat nuk janë zhvilluara në sistemin Bachelor të tilla si Menaxhimi i projekteve, Metodatat sasiore, Globalizimi e lëvizjet sociale, Decentralizimi etj, kjo për ta bërë më të plotë kuadrin e njohurive teorike dhe praktike të fituara nga studentët master.</p>
<p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p>	<p>UMSH nuk ofron programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, etj.</p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij. Kjo shihet dhe tek syllabuset përkatëse ku i vihet shumë rëndësi studentit, dhe mënyrës së organizimit të mësimi ku organizohen raste të ndryshme studimi me sens kritik për t'i bërë studentët më pjesmarrës dhe më të aftë në jetën reale. Kurse, lidhur me programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, etj, UMSH nuk i ofron këto lloj programesh.</p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>	<p>Në raportin konkret të GVJ që po diskutojmë, po diskutohet për programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike, të cilat i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale. Normalisht që UMSH ofron dhe mastera shkencorë, që krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë (doktoratës), duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve.</p>

<p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike, i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke ditur që tregu i punës në Shqipëri, rajon e më gjerë ka nevojë për specialistë në fushën e administrim biznesit dhe të administratës publike (kjo bazuar në lëndët dhe syllabuset përkatëse, me tema të cilat synojnë të kombinojnë më së miri teorinë dhe praktikën). Këta studentë, pas diplomimit mund të punojnë si administratorë të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, të kompanive të shërbimeve, në banka, sipërmarrje të tyre, në administratën publike në nivel qendror e lokal, institucionet kushtetuese, etj.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin I.2: <i>Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit</i>, konstatoj që ai është <i>plotësuar</i> si në aspektin e programeve të studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administrim Publik, programe të studimeve të cilat janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit, i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare Bachelor me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional, i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij, dhe kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës në Shqipëri e më gjerë. Kurse, lidhur me programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, etj, UMSH nuk i ofron këto programe të studimeve.</p>	
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p>	<p>Përmbatja e programeve të studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administrim Publik, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të tilla si Ligji për arsimin e lartë në RSH nr.9741, datë 21.5.2007, i ndryshuar; si dhe udhëzimet përkatëse të MASH_{it} (lëndët përkatëse janë në përputhje me emërtimin e programit dhe syllabuset përmbajnë të gjithë elementët: emërtimin e lëndës/modulit, llojin e programit, titullarin e lëndës, kualifikimin e tij/saj, viti/semestri kur zhvillohet, lëndë e e detyrueshme apo me zgjedhje, ECTS e saj, ngarkesa në leksione e seminare e lëndës, misionin/objektivat e lëndës/modulit, efektet e lëndës/modulit, temat përkatëse, vlerësimin e studentit, dhe literaturën bazë e ndihmëse).</p>
<p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Gjithashtu, ajo që mund të konstatohet është se emërtimi i programeve të studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administrim Publik është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin I.3: <i>Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi</i>, konstatoj që ai është <i>plotësuar</i> si në aspektin e programeve të studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administrim Publik, përmbatja e programeve të studimeve të cilave është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe emërtimi i programeve të studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe</p>	

Administrative me profil Administrim Publik është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.

Standardi I.4

- Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p>	<p>Përsa i përket përmbajtjes dhe renditjes së objektivave të programeve të studimeve MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administrim Publik (bazuar në RVB e UMSH dhe rregulloret e MP të UMSH), kjo gjë bëhet dhe gjithashtu pasqyrohen dhe objektivat e misionet në syllabuset përkatëse të lëndëve, dhe ku synohet arritja e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ato ofrohen.</p>
<p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit të studentëve në programet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administrim Publik (bazuar në RVB dhe rregulloren e UMSH, si dhe nga takimet me drejtues të studentëve të UMSH) bëhet duke kombinuar teste të ndryshme me shkrim dhe me gojë. Sistemi i vlerësimit të studentëve është me 10 nota, ku notat më të ulëta kaluese është nota 5 (neni 22 i rregullores MP të UMSH). Përdoren si pjesë e vlerësimit, prezantime të detyrave të ndryshme të studentëve, testet e vazhdueshme, detyrat e kursit dhe vijon me provimin përfundimtar (50-60% të pikëve) në fund të ciklit të lëndës. Forma e testeve përmban pyetje V/G, me alternativa, ushtrime dhe pyetje në formë eseje ku kërkohet mendimi kritik i studentëve (në cdo syllabus jepet forma e vlerësimit të studentëve). Me këtë lloj mënyrë vlerësimi, sigurohet një angazhim dhe pjesëmarrje më e madhe e studentëve dhe asimilim më i mirë i lëndës nga ata.</p>

Konkluzione:

Si konkluzion lidhur me **standartin I.4: Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve**, konstatoj që ai është *plotësuar* si në aspektin e programeve të studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, ku përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synon arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato, dhe me metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmon ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.

Standardi I.5

- Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavejeçare dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane</p>	<p>Duke konsideruar faktin që UMSH është anëtar i rrjetit të universiteteve të Mesdheut EMUN, rrjet ky i përbërë nga universitete të njohura në botë të tilla si në Francë, Angli, Gjermani, Itali, Greqi etj, duke krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi të vazhdueshme në formë projektesh të përbashkëta dhe shkëmbimi akademik me universitetet anëtare të këtij rrjeti, kjo ka bërë që programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik të mbështeten kryesisht në përvojën dhe praktikën e universiteteve më të mira të vendeve evropiane të përmendura më lart, si dhe duke krijuar lëndë që i përshtaten mjaft mirë specifikës së masterave profesionale, objektivave të tyre dhe ambientit shqiptar.</p>
---	---

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to, metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p>	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik janë të një niveli të lartë (kjo bazuar në lëndët e syllabuset përkatëse), me elementë përbërës ndërkombëtarisht konkures të tillë si planet mësimorë, objektivat përkatës, kreditet, kushtet e pranimit, metodat e vlerësimit, diploma që jepet në fund etj. Detyra që i ngelet UMSH është tërheqja dhe afrimi i studentëve sa më cilësorë për të krijuar një ambient sa më sfidues e konkures, kjo në të mirën e UMSH dhe arsimit të lartë në përgjithësi.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin 1.5: <i>Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare</i>, konstatoj që ai është <i>plotësuar</i> si në aspektin e programeve të studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, pra programe të mbështetura në praktikat më të mira të universiteteve evropiane, programe studimi të një niveli të lartë, me elementë përbërës ndërkombëtarisht konkures, dhe hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	
<p>Standardi 1.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p>	<p>Programet e studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, përfshijnë aftësimin profesional në fushën e administrim biznesit dhe të administratës publike. Kjo shihet përkatësisht dhe tek lëndët përkatëse dhe ngarkesës së përcaktuar për secilën nga ato në secilin program studimi, ku synohet si shpjegimi teorik i koncepteve, por i kombinuar dhe me aspektet praktike, raste studimore etj.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p>Duke marrë në konsideratë që qëllimi dhe misioni i UMSH është përgatitja e specialistëve të aftë në fushat e shkencave ekonomike, marrëdhënieve ndërkombëtare e diplomacisë, shkencave politike e administratës publike, programet e studimit master, veçanërisht programet e studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik janë në përputhje të plotë me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë jo publik UMSH dhe strategjinë e tij për zhvillim.</p>
<p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Personeli akademik i UMSH është i angazhuar në punën kërkimore shkencore duke marrë pjesë me punime shkencore të ndryshme në revistën shkencore të UMSH, Euromediterranean, si dhe në revista e konferenca të tjera brenda e jashtë vendit. Kjo gjë është mjaft e rëndësishme për ecurinë e UMSH duke ditur se është në funksion të realizimit sa më të mirë të programeve të studimeve master dhe në funksion të kualifikimit të mëtjshëm të pedagogëve duke marrë sa më shumë eksperiencë nga pedagogë e specialistë të vendit apo të huaj.</p>
<p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve master në UMSH përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij, sepse botimi i artikujve të ndryshëm në revista shkencore të njohura të vendit apo të huaja, dhe pjesmarrja në konferenca shkencore të vendit dhe të huaja, s'bën gjë tjetër veçse shërben në funksion të rritjes profesionale të pedagogëve të UMSH, në</p>

	fuksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, dhe në fuksion të rritjes së emrit dhe përmirësimit të imazhit të UMSH.
Konkluzione:	
Si konkluzion lidhur me standartin I.6: Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor , konstatoj që ai është <i>plotësuar</i> si në aspektin e programeve të studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, pra këto programe përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor, janë në përputhje me profilin e UMSH dhe strategjinë e tij për zhvillim, personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve, dhe puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të UMSH.	
Standardi I.7	
- Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Duke patur parasysh ndryshimet e shumta në Shqipëri si në aspektin ekonomik, politik etj, tek UMSH u konstatua se ka mbajtur parasysh hartimin dhe ofrimin e programeve të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës, si për programet MP në Administrim Biznesi me synim formimin e ekspertëve dhe specialistëve të mirë e të aftë për drejtimin e bizneseve të vogla e të mesme, dhe të ndërmarrjeve më të mëdha duke iu siguruar këtyre studentëve formim teorik dhe praktik në fushën e marketingut, menaxhimit strategjik, lidhshpimit etj; ashtu edhe për MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike me synim përgatitjen e administratorëve dhe funksionarëve publike të aftë për të kontribuar në zhvillimin përkatës të organizatave publike në Shqipëri. Specialistët në fushën e administrim biznesit dhe të administratës publike janë mjaft të kërkuar në tregun e punës në Shqipëri.
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Programet e studimeve të ciklit të dytë MP në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë shqiptare apo të huaj, duke ditur që tregu i punës në Shqipëri e më gjerë ka nevojë për specialistë të aftë në fushat e mësipërme. Madje, gjatë orëve të mësimin mbahet parasysh diskutimi i rasteve praktike të kompanive të huaja, ashtu dhe të kompanive apo organizatave vendase, qofshin këto private apo publike.
Konkluzione:	
Si konkluzion lidhur me standartin I.7: Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës , konstatoj që ai është <i>plotësuar</i> si në aspektin e programeve të studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, pra këto programe ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës, dhe synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	
Standardi I.8	
- Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Duke konsideruar tranzicionin e zgjatur që po përjeton Shqipëria si një vend i vogël në zhvillim, nga UMSH është mbajtur në konsideratë hartimi i programeve në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojave që imponohen nga ky zhvillim. Për këtë arsye, programet MP Administrim Biznesi janë të orientuara në fushën e administrim biznesit si një nga qëllimet bazë për drejtim të suksesshëm të bizneseve, dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administratë Publike duke konsideruar

	modernizimin dhe funksionimin sa më eficient dhe efektiv të administratës publike, në mënyrë për të bërë hapa gradualë e pozitivë në funksion të zhvillimit të vendit dhe të bërjes së tij vend i zhvilluar. Zhvillimi ekonomik si një nga qëllimet kryesore, sëbashku me modernizimin e administratës publike, e kombinuar dhe me marrëdhëniet ndërkombëtare e diplomacinë, këto kontribuojnë në përparimin dhe integrimin sa më të shpejtë të Shqipërisë në BE.
<p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <p>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;</p> <p>b. kërkesat e punëdhënësve;</p> <p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	Sa i përket vlerësimit të nevojave të tregut të punës, nga drejtues të UMSH u tha që synojnë të kryejnë 2 studime tregu gjatë vitit 2012 për të parë mundësitë reale të punësimit të studentëve, kërkesat e punëdhënësve për specialistët e diplomuar sipas fushave përkatëse të studimit të ofruara nga UMSH, si dhe lidhur me parashikime të përafërta për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program dhe numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.
<p>Konkluzione:</p> <p>Si konkluzion lidhur me standartin I.8: Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, konstatoj se është <i>plotësuar</i>, pra programet e studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar; kurse lidhur me vlerësimin e nevojave të tregut të punës, nga drejtues të UMSH u tha që synojnë të kryejnë 2 studime tregu gjatë vitit 2012.</p>	
<p>Standardi I.9</p> <p>- Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p>	Programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative me profil Administratë Publike (bazuar tek programet e syllabuset përkatëse) janë të hartuara në një mënyrë të tillë që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, përkundrazi synimi i tyre është aftësimi i specialistëve të fushave të mësipërme për t'i bërë ballë ndryshimeve të vazhdueshme që po ndodhin sot në Shqipëri e në botë.
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	Këto programe kanë një specifikë (bazuar tek programet e syllabuset përkatëse) sepse marrin në konsideratë jo vetëm kontekstin e Shqipërisë, por dhe kontekstin rajonal, duke marrë parasysh aspektet e zhvillimeve mesdhetare dhe evropiane të tilla si zhvillimet dhe proceset integruese ekonomike, zhvillimet dhe proceset gjeopolitike e kulturore, si dhe marrëdhëniet ndërmjet vendeve të Mesdheut dhe Evropës në kontekstin e proceseve dhe marrëdhënieve globale, dhe synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Në programet e studimit janë përfshirë edhe lëndë të tilla që adresojnë në mënyrë specifike historinë, proceset, marrëdhëniet, zhvillimet dhe kulturat mesdhetare si edhe gjuhët e vendeve të mesdheut.

<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin I.9: <i>Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare</i>, konstatoj që ai është <i>plotësuar</i> si në aspektin e programeve të studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, pra UMSH ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	
<p>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p>	<p>Lidhur me vlerësimin e rezultateve të programeve të studimeve, UMSH përdor konsultimet me stafin mësimdhënës, me ekspertë të jashtëm nga brenda e jashtë vendit, si dhe me studentët (kjo e konstatuar nga takimet me stafin dhe studentët), si dhe analizat krahasuese të programeve të ngjashme të studimeve që zbatohen në universitetet e tjera të vendit dhe të huaja, për të parë ecurinë e programeve të studimeve.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p>	<p>Sipas drejtuesve të UMSH, ata e përfshijnë këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë, si një mënyrë për të marrë feedback, i cili është mjaft i nevojshëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p>	<p>Përsa i përket publikimit të rezultateve të pritshme, sipas drejtuesve të UMSH synohet publikimi i tyre gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2011-2012.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: <u>Të tërthorta:</u> <ul style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <u>Të drejtpërdrejta:</u> <ul style="list-style-type: none"> a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); b. Dëgjime në auditor; c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar me nota/pikë; d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; </p>	<p>Metodat (bazuar në RVB e UMSH dhe konstatimet nga takimet me stafin dhe studentët të UMSH) që përdoren për kryerjen e vlerësimit përfshijnë pyetësorë drejtuar studentëve të UMSH, pedagogëve të UMSH, ekspertëve të ndryshëm, për të vlerësuar procesin e të mësuarit në UMSH, si dhe në vlerësimin e kurrikulave; intervista të ndryshme të strukturuar dhe të pastrukturuar; dëgjimet në auditor; vlerësimet me nota/pikë; testimet paraprake dhe përfundimtare; provimet për modulet, praktikat; vlerësimin e detyrave të kursit nga studentët për të analizuar procesin e të kuptuarit konceptual, provimet; si dhe vëzhgimet që synohen të bëhen gjatë procesit të praktikës.</p>

<p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin I.10: Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve, konstatoj se është plotësuar pothuajse 100%, pra që institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve dhe e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë, <i>synon publikimin e tyre gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2011-2012</i>, dhe për kryerjen e vlerësimin, institucioni përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta si ato të përmendura më lart.</p>	
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Nga ana e drejtuesve të UMSH u tha që me përfundimin e vitit akademik 2011-2012 synohet hartimi i një plani strategjik (aktualisht ekziston një plan strategjik për zhvillimin e kërkimit shkencor) në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve si për nivelin bachelor, ashtu dhe për nivelin master, bazuar në përpunimin e të dhënave të mbledhura deri më tani.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Nga ana e drejtuesve të UMSH u tha që me përfundimin e vitit akademik 2011-2012 synohet hartimi i një plani strategjik në nivel institucioni (aktualisht ekziston një plan strategjik për zhvillimin e kërkimit shkencor) për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit si për nivelin bachelor, ashtu dhe për nivelin master, bazuar në përpunimin e të dhënave të mbledhura deri më tani.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin I.11: Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit, konstatoj që kjo synohet të bëhet nga ana e drejtuesve të UMSH me përfundimin e vitit akademik 2011-2012 bazuar në përpunimin e të dhënave të mbledhura deri më tani.</p>	
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Masteri Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Nga ana e UMSH ofrohen dhe mastera shkencorë, por në këtë raport po diskutojmë për programet e studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik.</p>

<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi i studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi përmban 90 kredite ECTS me kohëzgjatje 1.5 vite akademike, dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik përmban 60 kredite ECTS me kohëzgjatje 1 vit akademik (neni 17 i rregullores së MP të UMSH).</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Në këtë raport po diskutojmë për programet e studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin I.12: <i>Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet që programi i studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi përmban 90 kredite ECTS me kohëzgjatje 1.5 vite akademike, dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik përmban 60 kredite ECTS me kohëzgjatje 1 vit akademik, në përputhje të plotë me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</i></p>	
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p>	<p>Nga ana e drejtuesve të UMSH u tha që UMSH ka në plan publikimin rregullisht të broshurave, buletineve etj, për vlerësimin e brendshëm, të cilat do tu bëhen të njohura studentëve, pedagogëve, ekspertëve dhe grupeve të tjera të interesuara.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Nga ana e drejtuesve të UMSH u tha që UMSH ka në plan publikimin rregullisht të prezantimeve në faqen zyrtare të internetit të UMSH, të videove e audiove etj, për vlerësimin e brendshëm, të cilat do tu bëhen të njohura studentëve, pedagogëve, ekspertëve dhe grupeve të tjera të interesuara.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin I.13: <i>Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm, konstatohet që nga ana e drejtuesve të UMSH synohet publikimi rregullisht i broshurave, buletineve, prezantimeve në faqen e saj të internetit, videove e audiove etj, për vlerësimin e brendshëm.</i></p>	
<p align="center">II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT BËHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE.</p>	
<p>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p>	<p>Nga informacionet e marra gjatë vizitave dhe takimeve në UMSH, u konstatua që personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i UMSH shfaqnin angazhim në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre. Kjo gjë në fakt është e reflektuar dhe në përkrahje të tyre të punës i cili i mban parasysh këto kërkesa, gjë të cilën ata e kanë mirëpritur.</p>

<p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Nga informacionet e marra gjatë vizitave dhe takimeve në UMSH, u konstatua që personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i UMSH shfaqnin angazhim në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Kjo gjë në fakt është e reflektuar dhe në përshkrimin e tyre të punës (të mbështetur në statutin dhe rregulloren e UMSH), i cili i mban parasysh këto kërkesa, gjë të cilën ata e kanë mirëpritur.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin II.1: <i>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve</i>, konstatohet që ai është <i>plotësuar</i>, pra personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i UMSH shfaqte angazhim në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe me strategjinë për zhvillim të UMSH për për arritjen e tyre.</p>	
<p>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p>	<p>Nga vizitat në UMSH konstatuam se UMSH organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi në mënyrë që të përmbushë misionin e saj (i shprehur në RVB e UMSH dhe nga drejtuesit e saj), mision i cili ka të bëjë me ndërtimin e një komuniteti mësimi dhe krijimi në të cilin respektohet dhe vlerësohet çdo pjesëtar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët nëpërmjet inspirimit dhe arritjeve të larta.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p>	<p>UMSH përbëhet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare e Diplomacisë dhe Fakulteti i Shkencave Politike dhe Administratës Publike.</p>
<p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p>	<p>UMSH është e organizuar në njësi bazë dhe përbëhet nga 3 fakultetet, ku secili nga ato përbëhet nga departamente. Kështu, Fakulteti i Shkencave Ekonomike, përbëhet nga Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet, dhe Departamenti i Menaxhimit; Fakulteti i Shkencave Politike dhe Administrative përbëhet nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Departamenti i Shkencave Administrative; dhe Fakulteti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare e Diplomacisë përbëhet nga Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamenti i Diplombacisë.</p>
<p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p>	<p>UMSH përbëhet nga 3 fakultete dhe secila përbëhet nga njësitë bazë përkatëse.</p>
<p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>UMSH ka pedagogë që japin mësim dhe që zotërojnë gradën shkencore ‘Doktor’, por ajo që u vu re është që shumica janë më kohë të pjesshme, prandaj në të ardhmen duhet të rritet numri i pedagogëve me kohë të plotë.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin II.2: <i>Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij</i>, konstatohet që është <i>plotësuar pjesërisht</i>, pra UMSH organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi në mënyrë që të përmbushë misionin e saj, përbëhet nga së paku 2 fakultete, dhe ku çdo fakultet përbëhet nga 2 departamente. UMSH ka pedagogë që japin mësim dhe që zotërojnë gradën shkencore ‘Doktor’, por ajo që u vu re është që shumica janë më kohë të pjesshme, prandaj në të ardhmen duhet të</p>	

rritet numri i pedagogëve me kohë të plotë.	
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;	Njësitë bazë dhe kryesore të UMSH janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve, konkretisht në mbështetje të statutit dhe rregullores së UMSH, Departamentet dhe Fakultetet shfaqin angazhim të drejtpërdrejtë në realizimin e programeve të studimeve (kjo konstatuar nga takimet me drejtuesit përkatës të tyre).
Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.	Njësitë bazë dhe kryesore të UMSH përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij, konkretisht në mbështetje të statutit dhe rregullores së UMSH, Departamentet dhe Fakultetet shfaqin angazhim të drejtpërdrejtë në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij, duke qenë anëtarë në konkurset e pranimit, dhe më pas në vlerësimin e punonjësve.
Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin II.3: Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve , konstatoj që është plotësuar, pra njësitë bazë dhe kryesore në UMSH janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve, dhe përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij, kjo bazuar në statutin dhe rregulloren e UMSH.	
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	Nga vizitat në UMSH u konstatua që të gjitha kurrikulat dhe vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve, janë hartuar nga personeli akademik i UMSH (duke përfshirë pedagogët me kohë të plotë dhe ata me kohë të pjesshme).
Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Lidhur me rekrutimin e personelit të ri dhe përcaktimin e ngarkesës mësimore, u konstatua se ajo bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke përfshirë Ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, i ndryshuar, Për arsimin e lartë në RSH ..., Udhëzimet përkatëse të MASH, statutin dhe rregulloren e UMSH që rregullojnë rekrutimet e personelit dhe ngarkesën mësimore.
Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin II.4: Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit , konstatoj që është plotësuar, pra personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme në UMSH luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve, si dhe rekrutimi i personelit të ri e përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (duke përfshirë ligjin për arsimin e lartë në RSH, udhëzimet e MASH, statutin dhe rregulloren e UMSH).	
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	UMSH e ushtron aktivitetin e saj mësimor në një godinë të marrë me qera, që shërben dhe si mjedis qendror administrativ, dhe ku ka infrastrukturën e shërbimit e nevojshme për zhvillimin sa më cilësor të mësimin dhe të kërkimit shkencor.

Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	UMSH i ka marrë këto mjedise me qera nëpërmjet një kontratë 10 vjeçare.
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	Programet e studimit ofrohen në një godinë të vetme duke siguruar në këtë mënyrë një kontroll të vazhdueshëm dhe menaxhim efikas për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që UMSH ofron.
Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	UMSH nuk ofron programe studimi në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.
Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin II.5: Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron , konstatoj se është <i>plotësuar</i> , pra UMSH e ushtron aktivitetin e saj mësimor në një godinë të vetme të marrë me qera me një kontratë 10 vjeçare, që shërben dhe si mjedis qendror administrativ, dhe ku ka infrastrukturën e shërbimit e nevojshme për zhvillimin sa më cilësor të mësimin dhe të kërkimit shkencor. Kurse, përsa i përket programeve të studimit në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj, UMSH nuk i ofron këto programe studimi.	
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshëm për studentët;	Nga vizitat e bëra në UMSH dhe diskutimet me studentët, u konstata se informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshëm për studentët, madje janë marrë dhe vërejtjet e sugjerimet e studentëve lidhur me to.
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Programet e studimit në UMSH, modulet dhe syllabuset e detajuara ofrohen në forma të ndryshme të shkruara npr broshurave dhe në formë elektronike (kjo u konstata tek vizitat e UMSH).
Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin II.6: Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve , konstatoj se është <i>plotësuar</i> , pra informacioni i ofruar nga UMSH për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshëm për studentët dhe ky informacion ofrohet për studentët në forma të ndryshme të shkruara npr broshurave dhe në formë elektronike.	
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Sipas drejtuesve të UMSH, ajo ka planifikuar hartimin e një analize vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë (duke përfshirë programet e studimeve të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik) në fund të muajit korrik 2012 (kjo duke ditur që MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik janë në proces dhe që zhvillohen për herë të parë).

<p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UMSH harton politika (dhe plan strategjik të zhvillimit të kërkimit shkencor) të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, veçanërisht lidhur me MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, politika që bazohen në konsultime me programet më të mira të universiteteve më të njohura në vend dhe ato të huaja, me ekspertë të njohur të vendit dhe të huaj, me grupet e interesit si studentë, prindër etj, me politikëbërës të sistemit arsimor universitar, me ekspertë të tregut të punës etj, politika të cilat synojnë përmirësimin e programeve të të studimeve master.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin II.7: <i>Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë</i>, konstatoj që UMSH (sipas drejtuesve të saj) ka planifikuar hartimin e një analize vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë në fund të muajit korrik 2012, dhe harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p>	<p>Sipas drejtuesve të UMSH, plani i diplomimit hartohet në fillim të semestrit të fundit individualisht nga çdo student sëbashku me drejtuesin e zgjedhur prej tij, që shpjegon periudhat kohore, angazhimet e duhura për diplomimin, dhe mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar.</p>
<p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Në këtë raport po diskutojmë për MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin II.8: <i>Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi</i>, konstatoj që plani i diplomimit hartohet në fillim të semestrit të fundit individualisht nga çdo student sëbashku me drejtuesin e zgjedhur prej tij, që shpjegon periudhat kohore, angazhimet e duhura për diplomimin, dhe mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar.</p>	
<p>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</p>	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p>	<p>UMSH bën auditim të jashtëm të përvitshëm të situatës së saj financiare, auditim i cili kryhet nga AIEI Auditors. UMSH ka dokumentuar raportet financiare të pasqyruara në pasqyrat financiare të përgatitura nga AIEI Auditors për vitet 2009-2010 dhe 2010-2011.</p>
<p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p>	<p>Raporti i auditimit paraqet të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit dhe shpenzimet operative. Në raportin që hartohet nga audituesit e jashtëm, jepet mendimi lidhur me pasqyrat financiare të tilla si pasqyra e fitimeve, bilanci, pasqyrohen grantet e përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë të studimeve në UMSH.</p>
<p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të</p>	<p>Në raportin e auditimit jepen dhe rekomandime të ndryshme përsa i përket administrimit financiar sa më eficient dhe efektiv të UMSH, përdorimit sa më të mirë të të ardhurave nga tarifat</p>

<p>rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve. Kjo gjë është detyrim ligjor për UMSH për të rritur dhe besueshmërinë e institucionit të saj.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin II.9: Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare, konstatoj që UMSH bën auditim të jashtëm të përvitshëm të situatës së saj financiare, auditim i cili kryhet nga AIEI Auditors, raportet e auditit të të cilave përmbajnë një pasqyrë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve, si dhe jepen dhe rekomandime të ndryshme përsa i përket administrimit financiar sa më eficient dhe efektiv të UMSH.</p>	
<p>III - PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA PERSONELI AKADEMIK, PERSONELI NDIHMËS MËSIMORSHKENCOR DHE PERSONELI ADMINISTRATIV.</p>	
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitat e bëra tek institucioni i arsimit të lartë jo publik UMSH konstatohet se ai ndjek procedura ligjore dhe bën përpjekje për transparencë në funksion të rekrutimit dhe vlerësimit të punonjësve të UMSH. Lidhur me rekrutimin e punonjësve, UMSH përdor procedurat e përzgjedhjes me konkurs duke bërë publikime të njoftimeve në gazeta, televizione apo dhe në faqen e internetit (në këtë rast publikohen edhe formularët e aplikimit). Janë departamentet e UMSH të cilat propozojnë kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik dhe për personel ndihmës mësimor shkencor për vendet e lira të punës. Dekani/Drejtori bën miratimin paraprak të procedurës pasi bën verifikimet e nevojshme, dhe më pas i dërgon për miratim tek Rektori, për ndjekjen e mëtejshme të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës. Kurse, kancelari propozon procedura të ngjashme për kandidatët për personel administrativ për vendet e lira të punës. Në të dyja rastet, kandidatët duhet të paraqesin paketën e plotë të aplikimit që përfshin formularët e aplikimit të plotësuar, tre letra rekomandimi nga pedagogë me tituj apo grada shkencore ku njëra të jetë nga punëdhënësi i fundit nëse ka një të tillë, fotokopje të noterizuar të diplomës, fotokopje të dokumenteve të identifikimit, të arsimit, të kualifikimeve apo të titujve shkencorë të fituar. Vlerësimi i kandidatëve për personel akademik bazohet në masën 70% në paketën e aplikimit dhe 30% merret nga intervista që zhvillohet me kandidatët që përfshihen në listat e përzgjedhura. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komisionet e vlerësimit të ngritura nga UMSH, të cilët shqyrtojnë paketat e aplikimit të kandidatëve, verifikojnë informacionet e paraqitura, dhe hartojnë një listë sipas pikëve të fituara në rendin zbritës për çdo specialitet, e cila paraqitet tek dekani, i cili në bashkëpunim me rektoratin, bazuar në rezultatet e listës paraprake, përcaktojnë kandidatët që do të thirren për t`ju nënshtruar intervistës. Pas përfundimit të procesit të intervistimit, komisioni për vlerësimin e kandidatëve harton listën me pikët përfundimtare për çdo kandidat ku përfshihen pikët nga paketa e aplikimit dhe pikët nga intervista, listë e cila diskutohet në rektorat, nga ku merret vendimi për kandidatët fitues. Procedura të ngjashme të përzgjedhjes, vlerësimit për rekrutimin ndiqeshin nga UMSH edhe për kandidatët për personel ndihmës mësimor-shkencor dhe personelin tjetër administrativ.</p>

<p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p>	<p>Sa i përket personelit akademik të punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, përgjithësisht një numër i konsiderueshëm pedagogësh janë më kohë të pjesshme, dhe normalisht që duhet rritur numri i pedagogëve me kohë të plotë (janë më pak se 70%) për t’ju përafuar standardeve, por UMSH ka bërë dhe po bën përpjekje për të rritur numrin e personelit akademik të punësuar me kohë të plotë, duke harmonizuar më së miri nevojat për pedagogë sipas lëndëve përkatëse dhe numrin e studentëve. Ky objektivi shprehet edhe tek plani i punës i UMSH për t’i kthyer pikat e dobëta në pika të forta, ku ai e konsideron si prioritet rritjen e nivelit të mësimdhënies nëpërmjet rritjes së numrit të pedagogëve të angazhuar me kohë të plotë, ku nga UMSH për vitin akademik 2011-2012 parashikohet që numri i stafit akademik të brendshëm të rritet me 10 pedagogë.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p>	<p>Bazuar në RVB, vizitat e bëra tek institucioni i arsimit të lartë jo publik UMSH dhe intervistat me punonjës të saj, konstatohet se ai ndjek procedura ligjore dhe bën përpjekje për transparencë në funksion të vlerësimit të punonjësve të UMSH. Lidhur me vlerësimin e personelit, UMSH ndjek procedurat ligjore të duhura për vlerësimin e tij. Përdoren pyetësorët që plotësohen nga studentët në fund të mbarimit të lëndës nga ku merret feedback mbi punën e bërë nga pedagogët gjatë semestrit, gjëra të cilat diskutohen dhe debatohen në departamentet përkatëse, dhe ku bëhet dokumentimi i gjithë këtij procesi. Gjithashtu, nga UMSH dokumentohen të gjitha të dhënat mbi raportet e rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë etj.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Në bazë të të dhënave të siguruara në Zyrën e Burimeve Njerëzore e të Rekrutimit të UMSH, u konstatua se ajo disponon një bazë të hollësishme të dhënash për të gjithë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në programet e studimit si dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, të dhëna të siguruara në formën e dosjeve të detajuara. Kjo zyrë gjithashtu disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor shkencor dhe të personelit administrativ, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin III.1: Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit, konstatohet se është <i>plotësuar pjesërisht</i>, pra UMSH ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren e saj, si dhe mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj, në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe të Rekrutimit. Sa i përket personelit akademik të punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, konstatohet se përgjithësisht një numër i konsiderueshëm pedagogësh janë më kohë të pjesshme, dhe normalisht që duhet rritur numri i pedagogëve me kohë të plotë (janë më pak se 70%) për t’ju përafuar standardeve.</p>	
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p>	<p>Përgjegjësi i programeve master në UMSH ka gradën PhD të fituar pranë një universiteti të huaj dhe është me përvojë akademike.</p>

<p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Masteri Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p>	<p>Në këtë raport po diskutojmë për MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik.</p>
<p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p>	<p>Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit për programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik kanë gradën shkencore ‘Doktor’ dhe në raste të caktuara me tituj më të lartë akademikë, si dhe me përvojë profesionale në fushat përkatëse.</p>
<p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p>	<p>Rektori i UMSH, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit dhe përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në UMSH që ofron programin e studimeve.</p>
<p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Në programin e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi për vitin 2011-2012 janë regjistruar 16 studentë, dhe për MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik janë regjistruar 6 studentë, studentë të cilët do të udhëhiqen dhe mbikqyren nga pedagogët e UMSH lidhur me praktikat profesionale.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin III.2: Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë, konstatoj se përgjegjësi i programeve master në UMSH ka gradën PhD të fituar pranë një universiteti të huaj dhe është me përvojë akademike, titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit për programet e studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik kanë gradën shkencore ‘Doktor’ dhe në raste të caktuara me tituj më të lartë akademikë [duhet theksuar se u bënë ndryshime pozitive në lidhje me zëvendësimin e titullarit (me grada e tituj shkencorë) të dy moduleve (njëra për shkak të humbjes së jetës) të cilat nuk ishin pasqyruar në planin mësimor], se UMSH siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikqyrjen e praktikave profesionale, dhe që rektori i UMSH, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit dhe përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në UMSH që ofron programin e studimeve.</p>	
<p>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p>	<p>Personeli akademik i UMSH është i angazhuar në punën kërkimore shkencore duke marrë pjesë me punime shkencore të ndryshme në revistën shkencore të UMSH, Euromediterranean, si dhe në revista e konferenca të tjera brenda e jashtë vendit (kjo u konstatua pikërisht nga revistat e botuara dhe artikujt e pedagogëve të UMSH në to). Kjo gjë është mjaft e rëndësishme për ecurinë e UMSH duke ditur se është në funksion të realizimit sa më të mirë të programeve të studimeve master dhe në funksion të kualifikimit të mëtjeshëm të pedagogëve duke marrë sa më</p>

	shumë eksperiencë nga pedagogë e specialistë të vendit apo të huaj.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve master në UMSH përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij, sepse botimi i artikujve të ndryshëm në revista shkencore të njohura të vendit apo të huaja, dhe pjesmarrja në konferenca shkencore të vendit dhe të huaja, s'bën gjë tjetër veçse shërben në funksion të rritjes profesionale të pedagogëve, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, në funksion të rritjes së emrit dhe përmirësimit të imazhit të UMSH, dhe në zhvillimin e shkencës në përgjithësi.
Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin III.3: Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve , konstatoj është <i>plotësuar</i> , pra personeli akademik i UMSH publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse, gjë e cila jep ndihmesën e saj në zhvillimin e shkencës dhe në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;	Gjuha e përdorur për mësimdhënie në programet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, është gjuha shqipe, por nga drejtues të UMSH u deklarua që do të organizohen në të ardhmen leksione publike apo module të veçanta me personel akademik të ftuar në kuadër të marrëveshjeve që ka UMSH me ekspertë apo akademikë të vendit e të huaj të fushave të ndryshme.
Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Gjuha e përdorur për mësimdhënie në programet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, është gjuha shqipe, por nga drejtues të UMSH u deklarua që do të organizohen në të ardhmen leksione publike apo module të veçanta me personel akademik të ftuar në kuadër të marrëveshjeve që ka UMSH me ekspertë apo akademikë të vendit e të huaj të fushave të ndryshme.
Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin III.4: Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar , konstatoj se gjuha e përdorur për mësimdhënie tek UMSH është gjuha shqipe, por nga drejtues të UMSH u deklarua që do të organizohen në të ardhmen leksione publike apo module të veçanta me personel akademik të ftuar në kuadër të marrëveshjeve që ka UMSH me ekspertë apo akademikë të vendit e të huaj të fushave të ndryshme.	
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;	Në këtë raport po diskutohet për MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik.
Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	Në këtë raport po diskutohet për MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike

	e Administrative me profil Administrim Publik.
Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.	Në këtë raport po diskutohet për MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik.
Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin III.5: <i>Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën,</i> konstatoj se në këtë raport po diskutohet për MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, por dhe për këtë, nga drejtues të UMSH u saktësua se udhëheqësit e studentëve kanë së paku gradën shkencore Doktor, dhe do të respektohej raporti 1 udhëheqës – 5 studentë për temat e diplomës.	
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.	Lidhur me programet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik tek UMSH, fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohen këto programe studime, madje këta pedagogë kanë përvojë në fushat përkatëse.
Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	Tek UMSH, udhëheqësit (pedagogë më kohë të plotë dhe të pjesshme) kanë njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.
Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin III.6: <i>Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza,</i> konstatoj se fusha studimore kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit, dhe udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;	Programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik që organizohen në UMSH nuk kanë në përbërjen e tyre orë laboratorike të cilat duhet të zhvillohen në laboratorë, por duke qenë se UMSH ka në dispozicion ambiente dhe infrastrukturën e duhur, në programe të tjera studimi mund të realizohen edhe orët laboratorike.

<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UMSH dëshmon për një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programit të studimit të ciklit të dytë, madje u konstatua një angazhim i madh i drejtuesve të UMSH.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin III.7: <i>Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përbushjen e misionit të tij</i>, konstatoj se programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik që organizohen në UMSH, zhvillohen në ambiente komode dhe me infrastrukturën e duhur, dhe se shihet një angazhim për një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p>	<p>Personeli akademik i UMSH e realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë nr.9741, datë 21.5.2007, i ndryshuar, udhëzimet e MASH, statutin dhe rregulloren e UMSH që rregullon ngarkesën mësimore.</p>
<p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik i UMSH në programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, si dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore sipas ligjit.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin III.8: <i>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi</i>, konstatoj se personeli akademik i UMSH e realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, ngarkesë e cila sëbashku me organizimin e drejtimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, vlerësohet me orë mësimore.</p>	
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p>	<p>Në bazë të të dhënave të siguruara në Zyrën e Burimeve Njerëzore e të Rekrutimit të UMSH, u konstatua se ajo disponon një bazë të hollësishme të dhënash për të gjithë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në programet e studimit si dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, të dhëna të siguruara në formën e dosjeve të detajuara.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore dhe e Rekrutimit të UMSH gjithashtu disponon listën e plotë të personelit akademik me kohë të plotë e të pjeshme, për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor shkencor dhe të personelit administrativ.</p>

<p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Bazuar ne RVB dhe vizitat e bëra tek institucioni i arsimit ta lartë jo publik UMSH konstatohet se ai ndjek proçedura ligjore dhe bën përpjekje për transparencë në funksion të rekrutimit të punonjësve të UMSH.</p> <p>Lidhur me rekrutimin e punonjësve, UMSH përdor proçedurat e përzgjedhjes me konkurs duke bërë publikime të njoftimeve në gazeta, televizione apo dhe në faqen e internetit (në këtë rast publikohen edhe formularët e aplikimit). Janë departamentet e UMSH të cilat propozojnë kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik dhe për personel ndihmës mësimor shkencor për vendet e lira të punës. Dekani/Drejtori bën miratimin paraprak të proçedurës pasi bën verifikimet e nevojshme, dhe më pas i dërgon për miratim tek Rektori, për ndjekjen e mëtejshme të proçedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës. Kurse, kancelari propozon proçedura të ngjashme për kandidatët për personel administrativ për vendet e lira të punës. Në të dyja rastet, kandidatët duhet të paraqesin paketën e plotë të aplikimit që përfshin formularët e aplikimit të plotësuar, tre letra rekomandimi nga pedagogë me tituj apo grada shkencore ku njëra të jetë nga punëdhënësi i fundit nëse ka një të tillë, fotokopje të noterizuar të diplomës, fotokopje të dokumenteve të identifikimit, të arsimit, të kualifikimeve apo të titujve shkencorë të fituar. Vlerësimi i kandidaturave për personel akademik bazohet në masën 70% në paketën e aplikimit dhe 30% merret nga intervista që zhvillohet me kandidatët që përfshihen në listat e përzgjedhura. Vlerësimi i kandidaturave bëhet nga komisionet e vlerësimit të ngritura nga UMSH, të cilët shqyrtojnë paketat e aplikimit të kandidatëve, verifikojnë informacionet e paraqitura, dhe hartojnë një listë sipas pikëve të fituara në rendin zbritës për çdo specialitet, e cila paraqitet tek dekani, i cili në bashkëpunim me rektoratin, bazuar në rezultatet e listës paraprake, përcaktojnë kandidatët që do të thirren për t`ju nënshtruar intervistës. Pas përfundimit të proçesit të intervistimit, komisioni për vlerësimin e kandidatëve harton listën me pikët përfundimtare për çdo kandidat ku përfshihen pikët nga paketa e aplikimit dhe pikët nga intervista, listë e cila diskutohet në rektorat, nga ku merret vendimi për kandidatët fitues. Proçedura të ngjashme të përzgjedhjes, vlerësimit për rekrutimin ndiqeshin nga UMSH edhe për kandidatët për personel ndihmës mësimor-shkencor dhe personelin tjetër administrativ.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin III.9: Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij, konstatoj se është <i>plotësuar, pra</i> Zyra e Burimeve Njerëzore e të Rekrutimit të UMSH disponon një bazë të hollësishme të dhënash për të gjithë anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë e të pjeshme të përfshirë në programet e studimit për secilin semestër, si dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, të dhëna të siguruar në formën e dosjeve të detajuara; listën e plotë të personelit ndihmës mësimor shkencor dhe të personelit administrativ; si dhe UMSH përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p>	<p>UMSH nxit kualifikimin shkencor dhe profesional të pedagogëve dhe punonjësve shkencorë duke ofruar programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor duke i nxitur ata të marrin pjesë në projekte të ndryshme kërkimore-shkencore, të financuara nga UMSH, duke organizuar sesionet verore për kualifikimet e pedagogëve dhe të punonjësve shkencorë sipas tematikave të caktuara, si dhe financimin e botimit të artikujve të ndryshëm nga pedagogët e UMSH.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>UMSH i ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit (kjo u konstatua dhe nga bisedat me stafin), financimin e pjesëmarrjes së tyre në udhëtime studimore në universitete të huaja, financimin e botimeve të pedagogëve dhe punonjësve shkencorë nga UMSH Press ose ente të tjera botuese, brenda dhe jashtë vendit. Të gjitha këto ndikojnë në kualifikimin e pedagogëve dhe në përmirësimin e përditësimin e programeve të studimit.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin III.10: Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij, konstatoj se është <i>plotësuar</i>, pra UMSH nxit kualifikimin shkencor dhe profesional të pedagogëve dhe punonjësve shkencorë duke ofruar programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të tyre, që ndikojnë në kualifikimin e pedagogëve dhe në përmirësimin e përditësimin e programeve të studimit.</p>	
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p>	<p>UMSH disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë e të pjeshme (gjë e konstatuar nga vizitat në UMSH) në programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik (kryesisht këto të siguruara nëpërmjet CV_{ve} të personelit akademik me kohë të pjeshme).</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p>	<p>UMSH përgjithësisht (jo 100%) disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik (një pjesë kryesore e pedagogëve janë me kohë të pjeshme, dhe është pak e vështirë sigurimi i gjithë databases për ta).</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>UMSH përgjithësisht (jo 100%) disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë personeli akademik i angazhuar në programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik (një pjesë kryesore e pedagogëve janë me kohë të pjeshme, dhe është pak e vështirë sigurimi i gjithë databases për ta).</p>

Konkluzione:

Si konkluzion lidhur me **standartin III.11**: *Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij*, konstatoj se UMSH disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik; si dhe UMSH përgjithësisht (jo 100%) disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik apo projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këto programe studimi.

IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE**Standardi IV.1**

- Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p>	<p>Nga inspektimet e bëra tek UMSH, rezultoi se studentët që ndjekin programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik zotërojnë së paku diplomën universitare Bachelor dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p>
<p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p>	<p>Pranimi në programet e integruara të studimeve tek UMSH bëhet në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p>	<p>Studentët që ndjekin programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik i plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga UMSH.</p>
<p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p>	<p>Studentët që ndjekin programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik janë të informuar se deri në fund të këtij programi studimi duhet të japin gjuhën angleze të nivelit B2.</p>
<p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Nga ana e drejtuesve të UMSH na u tha që ata vlerësojnë herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe në të ardhmen do të hartohen plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>

Konkluzione:

Si konkluzion lidhur me **standartin IV.1**: *Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë*, konstatoj se është *plotësuar*, pra studentët që ndjekin programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik zotërojnë së paku diplomën universitare Bachelor dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS; pranimi në programet e integruara

<p>të studimeve tek UMSH bëhet në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi; studentët që ndjekin programet e studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik janë të informuar se deri në fund të këtij programi studimi duhet të japin gjuhën angleze të nivelit B2, dhe nga ana e drejtuesve të UMSH vlerësohen herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimi i tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programet e studimit.</p>	
<p>Standardi IV. 2 - Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p>	<p>Nga ana e drejtuesve të UMSH u jepet informacion studentëve për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve (kjo u konstatua dhe nga një takim me studentët që ndjekin studimet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik).</p>
<p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p>	<p>Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda e jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga UMSH (kjo u konstatua dhe nga një takim me studentët që ndjekin studimet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik).</p>
<p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Në UMSH është ngritur Zyra e Këshillimit të Karrierës që merret me informimin e studentëve të ardhshëm (maturantët aplikantë) për programet e studimeve që ofron UMSH dhe kërkesat, politikat dhe standartet e pranimit; këshillimin e studentëve të UMSH_{së} që diplomohen në nivelin e parë për mundësitë e studimeve në nivelin e dytë, në UMSH ose universitete të tjera, të vendit dhe të huaja; këshillimin e studentëve të UMSH_{së} që diplomohen në nivelin e parë dhe të dytë për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës, në sektorin publik dhe privat, si edhe mundësitë e punësimit në tregjet rajonale dhe më gjerë, etj.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin IV.2: Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit, konstatoj se nga ana e drejtuesve të UMSH u jepet informacion studentëve për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve, informacion për akreditimin e UMSH dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda e jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga UMSH (kjo u konstatua dhe nga një takim me studentët që ndjekin studimet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik), si dhe studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	
<p>Standardi IV. 3 - Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p>	<p>UMSH pret të diplomojë brezin e parë të studentëve që ndjekin studimet MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik në fundin e vitit 2012, dhe ata që ndjekin MP Administrim Biznesi në mesin e vitit 2013.</p>

<p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p>	<p>Sekretaria mësimore e UMSH disponon statistika vjetore (gjë e konstatuar nga vizitat përkatëse tek sekretaria mësimore e UMSH) për numrin e studentëve të regjistruar në programin MP Administrim Biznesi (16 studentë) dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik (6 studentë), si dhe për tërheqjet apo largimet e mundshme para përfundimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Sekretaria mësimore e UMSH disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programeve të studimeve MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik duke filluar që nga pranimi i tyre.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin IV.3: <i>Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, konstatoj se UMSH pret të diplomojë brezin e parë të studentëve që ndjekin studimet MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik në fundin e vitit 2012; sekretaria mësimore e UMSH disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar dhe ecurinë e tyre që nga pranimi në programin MP Administrim Biznesi (16 studentë) dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik (6 studentë).</i></p>	
<p>Standardi IV. 4 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p>	<p>UMSH pret të diplomojë brezin e parë të studentëve që ndjekin studimet MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik në fundin e vitit 2012, dhe ata që ndjekin MP Administrim Biznesi në mesin e vitit 2013.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>UMSH pret të diplomojë brezin e parë të studentëve që ndjekin studimet MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik në fundin e vitit 2012, dhe ata që ndjekin MP Administrim Biznesi në mesin e vitit 2013.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin IV.4: <i>Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, konstatoj se UMSH pret të diplomojë brezin e parë të studentëve që ndjekin studimet MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik në fundin e vitit 2012, dhe ata që ndjekin MP Administrim Biznesi në mesin e vitit 2013.</i></p>	
<p>Standardi IV. 5 - Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e</p>	<p>Nga vizitat e bëra në UMSH dhe diskutimet me studentët, u konstatua se sekretaria mësimore dhe pedagogët e UMSH informojnë në mënyrë të detajuar studentët për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe</p>

studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;	organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit, etj (kjo u konstatua dhe nga një takim me studentët që ndjekin studimet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik).
Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;	Sekretaria mësimore dhe pedagogët e UMSH informojnë në mënyrë të vazhdueshme studentët për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit (kjo u konstatua dhe nga një takim me studentët që ndjekin studimet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik).
Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.	Titullari i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve, duke marrë dhe sugjerimet e studentëve lidhur me to (kjo u konstatua dhe nga një takim me studentët që ndjekin studimet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik).
Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin IV.5: Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve , konstatoj se është <i>plotësuar</i> , pra sekretaria mësimore dhe pedagogët e UMSH informojnë në mënyrë të detajuar studentët për programet e studimeve, afatin e përfundimit e organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit, për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit; si dhe titullari i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve, duke marrë dhe sugjerimet e studentëve lidhur me to (kjo u konstatua dhe nga një takim me studentët që ndjekin studimet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik).	
Standardi IV. 6 - Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	Nga ana e strukturave përkatëse të UMSH, u ofrohet këshillim studentëve, ndiqet ecuria e tyre dhe i ndihmojnë për trajtimin e zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor (kjo u konstatua dhe nga një takim me studentët që ndjekin studimet MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik).
Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	UMSH pret të diplomojë brezin e parë të studentëve që ndjekin studimet MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik në fundin e vitit 2012, dhe ata që ndjekin MP Administrim Biznesi në mesin e vitit 2013. Në kohën e duhur, nga ana e strukturave përkatëse të UMSH (zyra e karrierës) u deklarua që do t'i ndihmojnë studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale. UMSH ka bashkëpunime me Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë të Tiranës, Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, Shoqatën e Bankave të Shqipërisë, etj.

Konkluzione:

Si konkluzion lidhur me **standartin IV.6: Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve**, konstatoj se nga ana e strukturave përkatëse të UMSH (zyra e karrierës) u ofrohet këshillim studentëve, ndiqet ecuria e tyre dhe i ndihmojnë për trajtimin e zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor, si dhe treguan predispozicion për t'i ndihmuar studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale (për studentët e MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik në periudhën vjeshtë-dimër 2012). Nga takimet me studentët përkatës në UMSH, ata kishin përshtypje pozitive lidhur me këtë aspekt.

V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI

Standardi V. 1 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p>	<p>UMSH vë në dispozicion të studentëve, pedagogëve dhe punonjësve kërkimorë-shkencorë tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi, një literaturë të pasur, gjë e cila mundësohet nëpërmjet bibliotekës së UMSH të vendosur në katin e parë të këtij institucioni. Pasurimi i bibliotekës është një nevojë e përhershme e UMSH_{së} duke konsideruar dinamikën e zhvillimit të kurrikulave dhe përfshirjen e temave aktuale në fusha të ndryshme si të ekonomisë, politikës e administrimit publik.</p>
<p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>Biblioteka përmban literaturë të mjaftueshme që i ndihmon studentët për realizimin me sukses të programit të studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik. Këto tekste konsistojnë në përkthime të teksteve bazë të autorëve klasikë të shkencave ekonomike, politike, administrative dhe marrëdhënive ndërkombëtare; përkthime të teksteve të autorëve të njohur ndërkombëtarë të shkencave ekonomike, politike, administrative dhe marrëdhënive ndërkombëtare; botime të autorëve të njohur shqiptarë në fushën e shkencave ekonomike, politike, administrative dhe marrëdhënive ndërkombëtare. Normalisht që biblioteka e UMSH duhet të pasurohet në mënyrë të vazhdueshme me libra, revista të ndryshme në funksion të përmirësimit të cilësisë në UMSH.</p>
<p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>Gjithashtu, nga biblioteka e UMSH po krijohen mundësi përdorimi nga studentët dhe pedagogët të literaturës së nevojshme në rrugë elektronike. Për momentin, ekziston një database elektronik me botime periodike elektronike, të ndara në foldera sipas fushës përkatëse të të interesuarve. Nga stafi i UMSH po punohet për të krijuar marrëveshje për përdorimin e librarisë elektronike të universiteteve të njohura të huaja.</p>
<p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p>	<p>UMSH cakton çdo vit një fond prej rreth 500,000 lekë për blerjen e teksteve të ndryshme shkollore, si dhe abonimin dhe marrjen e revistave të njohura të vendit dhe botërore, si dhe po hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët.</p>
<p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të</p>	<p>Përsa i përket orareve të punës të bibliotekës së UMSH_{së}, ato</p>

shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	shpallen në katin të parë dhe në hyrje të saj, për të mundësuar një koordinim dhe përdorim sa më të mirë të literaturës dhe hapësirës që gjendet aty (kjo gjë u konstatua nga vizita në vend tek biblioteka e UMSH).
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin V.1: Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij, konstatoj se UMSH nëpërmjet bibliotekës së saj siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme e bashkëkohore; nga biblioteka e UMSH po krijohen mundësi përdorimi nga studentët dhe pedagogët të literaturës së nevojshme edhe në rrugë elektronike; koordinimi i orareve të përdorimit të saj duket mjaft i mire (kjo nga diskutimet me pedagogë e studentë të ndryshëm); si dhe kanë plane ambicioze për pasurimin e saj në të ardhmen.</p>	
<p>Standardi V.2 - Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p>	<p>Nga vizitat e bëra në ambientet e UMSH^{së}, konstatohet se ky institucion vë në dispozicion të studentëve, pedagogëve dhe punonjësve të tjerë të tij një bazë të mjaftueshme llogjistike ku bëjnë pjesë; laboratorë, klasa, zyra, studio dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike, me printera, fotokopje, video projektorë, duke patur shërbim të vazhdueshëm interneti kabllor dhe jo kabllor (wireless). UMSH vendos në dispozicion të studentëve, pedagogëve dhe punonjësve të tjerë të tij, laboratorin e teknologjisë së informacionit dhe që përbëhet nga një sasi e konsiderueshme kompjuterash (20 kompjutera për studentët, 9 kompjutera për stafin akademik, 4 kompjutera për administratën, të cilat janë të pajisura me programe profesionale në statistikë, ekonomi, shkenca politike etj), printera (1 printer rrjeti dhe 2 printera lokalë), fotokopje (1 fotokopje rrjeti) dhe videoprojektorësh (5 video projektorë).</p>
<p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p>	<p>Këto pajisje të këtyre mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien dhe në përputhje me të gjitha standardet e cilësisë të njohura ndërkombëtarisht.</p>
<p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p>	<p>Laboratorët janë bashkëkohore dhe përmbajnë të gjitha mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve (kjo gjë e konstatuar nga vizitat në vend). Nga takimet me studentët e UMSH, ata shpreheshin të kënaqur me të gjitha fasilitetet e ofruara nga ky institucion, me një infrastrukturë moderne me të gjitha kushtet bashkëkohore.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>UMSH vendos në dispozicion të studentëve laboratorin e kompjuterave për kryerjen e leksioneve dhe seminareve të ndryshme në varësi të temave specifike që diskutohen.</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin V.2: Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore, konstatoj se UMSH vë në dispozicion të studentëve, pedagogëve dhe punonjësve të tjerë të tij një bazë të mjaftueshme llogjistike ku</p>	

bëjnë pjesë; laboratorë, klasa, zyra, studio dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike, me printera, fotokopje, video projektorë, duke patur shërbim të vazhdueshëm interneti kabllor dhe jo kabllor; mjedise e laboratorë mësimore të përshtatshëm për mësimdhënien dhe në përputhje me të gjitha standardet e cilësisë të njohura ndërkombëtarisht.

Standardi V.3

- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.

<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p>	<p>Në shërbim të zhvillimit të praktikës profesionale për studentët e programeve të studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, UMSH ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi efektive me përfaqësues dhe organizata të ndryshme të sektorit privat e publik në Shqipëri dhe vende të rajonit, ndër të cilat mund të përmenden bashkëpunimi me Dhomën e Tregtisë dhe të Industrisë të Tiranës, Bashkinë Durrës, Njësinë Bashkiake nr.1 Tiranë, Bashkinë Sarandë, Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, Shoqatën e Bankave të Shqipërisë, Aleancën e Biznesit të Kosovës, Bankën Popullore (për të cilat u konstatuan marrëveshjet dhe memorandumet e bashkëpunimit ndërmjet UMSH dhe palëve përkatëse) etj. Gjithësesi, ngelet për tu parë eficienta dhe efektiviteti i këtij bashkëpunimi kur të kryhen praktikat e studentëve të parë që përfundojnë studimet master.</p>
<p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Në këtë raport po diskutojmë për MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik.</p>

Konkluzione:

Si konkluzion lidhur me **standartin V.3: Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij**, konstatoj se në shërbim të zhvillimit të praktikës profesionale për studentët e programeve të studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik, UMSH ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi efektive me përfaqësues dhe organizata të ndryshme të sektorit privat e publik në Shqipëri dhe vende të rajonit.

VI - INSTITUCIONI KA DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;</p>	<p>UMSH ka dokumentuar raportet financiare të pasqyruara në bilancin financiar të audituar nga AIEI Auditors për vitet 2009-2010 dhe 2010-2011.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme</p>	<p>Sipas drejtuesve të UMSH dëshmohet garanci e nevojshme financiare në llogaritë e veta bankare, por nuk kishim akses për të</p>

për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	grykuar për kapacitetet financiare për të ardhmen.
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin VI.1: <i>Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve, nga UMSH është bërë dokumentimi i raporteve financiare të pasqyruara në bilancin financiar të audituar nga AIEI Auditors për vitet 2009-2010 dhe 2010-2011, kurse përsa i përket llogarive bankare, ky është informacion konfidencial e nuk patëm aksesin e nevojshëm për një gjykim të plotë.</i></p>	
<p>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</p>	
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p>	<p>UMSH për hartimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik nxit vazhdimisht bashkëpunimin e frytshëm dhe produktiv ndërmjet personelit, duke shkëmbyer informacion të vlefshëm në funksion të arritjes së objektivave individuale dhe të institucionit (kjo gjë u konstatua nga takimet me drejtues të lartë të UMSH dhe persona të tjerë të stafit të saj).</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>UMSH ka bërë ndarje të detyrave mes personelit brenda institucionit, dhe synon marrjen e përgjegjësisë respektive dhe analizën e vazhdueshme të punës së tyre, duke garantuar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi ndërmjet personelit (kjo gjë u konstatua nga takimet me drejtues të lartë të UMSH dhe persona të tjerë të stafit të saj).</p>
<p>Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin VII.1: <i>Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet, konstatohet se UMSH për hartimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike e Administrative me profil Administrim Publik nxit vazhdimisht bashkëpunimin e frytshëm dhe produktiv ndërmjet personelit dhe ka bërë ndarje të detyrave mes personelit brenda institucionit, dhe synon marrjen e përgjegjësisë respektive e analizën e vazhdueshme të punës së tyre.</i></p>	
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p>	<p>UMSH ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel kombëtar, rajonal e ndërkombëtar për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të tij. UMSH është anëtar i rrjetit të universiteteve të Mesdheut EMUN, rrjet ky i përbërë universitete të njohura në botë të tilla si Universiteti Montpellier I, Francë; Universiteti Paris-Est, Francë, Universiteti Méditerranée-Aix Marseille-II, Francë; Universiteti Èestminster, Londër, Angli; Universiteti Politeknik i Valencias (UPV), Spanjë etj; duke krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi të vazhdueshme në formë projektesh të përbashkëta dhe shkëmbimi akademik me universitetet anëtare të këtij rrjeti. Kështu, UMSH ka krijuar marrëveshje bashkëpunimi me një numër institucioneve të huaja të arsimit të lartë për të ndërmarrë aktivitete të përbashkëta kërkimi, për të shkëmbyer materialet dhe publikimet akademike, për shkëmbimin dhe mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve, për bashkëpunime në çështjet administrave, universitete të tilla si</p>

	Universitetin e Qipros, Qipro; Universitetin Dimitrie Cantemir Christian University, Rumani; Universitetin Instabul Aydin, Turqi; Kolegjin Universitar Biznesi, Prishtinë, Kosovë; Universitetin e Veronës, Itali; Universitetin Dzemal Bijedic të Mostarit, Bosnjë-Hercegovinë; Universitetin e Tuzlës, Bosnjë-Hercegovinë, etj.
Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;	Lidhur me praktikat profesionale për studentët, UMSH _{ja} ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi efçente dhe efektive me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të ndryshme të sektorit privat e publik, prodhuese apo të shërbimit në Shqipëri. Kështu, UMSH ka ndërtuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tilla si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Shoqata e Bankave të Shqipërisë, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (u panë të firmosura marrëveshje e memorandume të ndryshme bashkëpunimi ndërmjet UMSH dhe subjekteve përkatëse), etj.
Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;	Sipas drejtuesve të UMSH, ajo ka në plan organizimin e trajnimeve profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit (brezi i parë i studentëve MP diplomohet në fundin e vitit 2012 dhe një pjesë në mesin e vitit 2013).
Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Sipas drejtuesve të UMSH, ajo ka në plan të bëjë një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.
Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin VII.2: Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj , konstatohet se UMSH ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj; ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës në varësi të programeve të studimeve që ofron; si dhe sipas drejtuesve të saj, UMSH ka në plan organizimin e trajnimeve profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit dhe të bëjë një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË	
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;	UMSH ka akredim institucional për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor (vendimi nr.303, date 13.01.2012 i KA: Për akreditimin institucional dhe programeve të studimit që përfundojnë me Bachelor Ekonomi, me profile: Financë-Bankë dhe Kontabilitet; Administrim Biznesi; Biznes dhe Ligj; Bachelor Marrëdhënie Ndërkombëtare/ Diplomaci; Bachelor Shkenca Politike – Administratë publike, me profile: Administratë publike; Shkenca Politike, të institucionit 'Shkolla e Lartë Private Mesdhetare e Shqipërisë': Burimi: APAAL).
Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;	UMSH përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Kështu, bëhet kontroll i brendshëm i mësimdhënies nga specialistë të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave. Rezultatet e kontroleve të orëve mësimore, bëhen më pas objekt diskutimesh në mbledhjet e departamenteve ku nxirren përfundime apo marren masat për të korigjuar aspektet problematike të punës. Përveç kësaj, merren parasysh dhe vlerësimet që japin studentët në përfundim të çdo lënde, të cilat kryhen para provimit, nga persona të paanshëm (jo vetë pedagogët) dhe përpunohen nga

	dega mësimore dhe njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave. Rezultatet e pyetësorëve diskutohen dhe analizohen në mbledhjet e departamenteve për të shkëmbyer eksperiencat pozitive dhe për të minimizuar ato negative.
Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;	Në bazë të Statutit dhe Rregullores të institucionit të arsimit të lartë jo publik UMSH dhe në bazë të ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, UMSH ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe të zhvillimit të kurrikulave, e cila ju sugjeron departamenteve dhe dekanateve organizimin, eksperimentimin dhe praktikimin e metodave të reja bashkëkohore të mësimdhënies. NjsBC ka përdetyrë vlerësimin periodikisht çdo semester të efikasitetit të veprimtarive mësimore, kërkimore dhe praktikave profesionale, provimet me shkrim, si dhe në raste të veçanta për kurse të veçanta; ndjekjen e procesit të mësimdhënies dhe evidentimin e praktikave më të mira si edhe praktikatat e këqia; etj.
Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;	Sipas drejtuesve të UMSH, ajo përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit. Procedura është e tillë që materialet e vlerësimit periodik të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave i kalojnë Rektorit dhe Bordit të Universitetit. Vlerësimet me shkrim të kontroleve periodike të cilësisë për mësimdhënien shqyrtohen në një nga mbledhjet e Senatit të UMSH _{se} dhe vendimet për përmirësimin e gjendjes merren në Senat.
Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;	UMSH synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e vazhdueshëm të saj (kjo gjë u konstatua dhe nga takimet që u bënë me personelin dhe studentët MP të UMSH).
Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	UMSH ka hartuar strategji, politika dhe procedura afatshkurtra, afatmesme e afatgjata në funksion të mbijetesës dhe rritjes së konkureshmërisë së UMSH nëpërmjet rritjes e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë (madje ka hartuar një plan strategjik për kërkimin shkencor në UMSH, ku jepen objektivat me hapat përkatës, përgjegjësit dhe afatet për realizimin e tyre, kjo në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të UMSH, forcimit të kërkimit shkencor, të krijimit të një baze të qëndrueshme financiare, të rritjes së bashkëpunimit me grupet e interesit dhe sektorin publik, të rritjes sasiore dhe cilësore të numrit të botimeve të stafit të UMSH, etj). UMSH merr masa për vlerësimin e programit të studimit përkatës nga treguesit e punësimit të të diplomuarve të secilit program. Vlerësimi i parë i këtij lloji është parashikuar të realizohet në semestrin e parë të vitit akademik 2012-2013, pasi të ketë dalë në treg kursi i të diplomuarve të vitit 2012.
Konkluzione: Si konkluzion lidhur me standartin VIII.1: Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve , konstatohet se UMSH përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë; përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit; synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e vazhdueshëm të saj; si dhe UMSH ka hartuar strategji, politika dhe procedura afatshkurtra, afatmesme e afatgjata në funksion të mbijetesës dhe rritjes së konkureshmërisë së UMSH nëpërmjet rritjes e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.	

Analiza SWOT për institucionin UMSH (duke përfshirë programet e studimeve të ciklit të dytë MP në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike)

Pikat e forta (S)

1. Infrastruktura bashkëkohore dhe kushtet mjaft të mira për zhvillimin e procesit mësimor;
2. Programet mësimore sipas standardeve të kohës;
3. Stafit akademik mësimdhënës me eksperiencë të lartë teorike dhe praktike;
4. Përkushtim i stafit akademik në mësimdhënie duke kombinuar mjaft mirë teorinë me praktikën;
5. Bashkëpunimet e ndryshme të UMSH me institucione të ndryshme brenda vendit dhe universitete të huaja;
6. Imazh pozitiv drejt konsolidimit të mëtejshëm.

Pikat e dobëta (W)

1. Numri i vogël i pedagogëve të punësuar me kohë të plotë;
2. Biblioteka e UMSH ende në plotësim me libra sipas fushës së programeve të studimit të ciklit të dytë MP Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike.
3. Mungesa e kritereve cilësore për pranimin e studentëve për kryerjen e studimeve master pranë UMSH;
4. Probleme me aksesin e literaturës apo mungesa në bibliotekë të literaturës në gjuhën angleze, kjo duke marrë në konsideratë dhe faktin që gjuha angleze është detyrim sipas ligjit shqiptar për studentët që mbarojnë studimet master, pra dobishmërinë për literaturë e libra në gjuhën angleze;
5. Ngarkesa e lartë administrative e stafit, kjo nga mbivendosja e punëve të caktuara;
6. Mospërfshirja e studentëve në kërkimin shkencor duke marrë pjesë në konferenca shkencore dhe të organizuar me grupe të vogla.

Oportunitetet (shanset) (O)

1. Zgjerimi i bashkëpunimeve brenda dhe jashtë vendit, në drejtim të kërkimit shkencor dhe shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve;
2. Motivimi i lartë i pedagogëve dhe personelit administrativ e ndihmës (konkluzion ky nga takimet e bëra me pedagogë të ndryshëm të UMSH dhe stafin administrativ ndihmës);
3. Lëvizshmëria e pedagogëve dhe studentëve në universitete të tjera me të cilat UMSH ka marrëveshje;
4. Imazhi publik i UMSH që synohet të rritet më shumë në të ardhmen kjo e siguruar nga profili publik i drejtuesit/esve më të lartë të saj;
5. Burimet financiare (sipas drejtuesit/esve, ky element do t'i shërbejë UMSH për ta shndërruar në fuqi në të ardhmen).

Kërcënimet (T)

1. Konkurenca nga universitete të tjera private brenda vendit me tarifa më të ulëta për studentët si dhe ata duke ofruar paga më të larta për pedagogët;

2. Konkurenca nga universitete të tjera jashtë vendit (kryesisht BE);
3. Vështirësi në të ardhmen e afërt të numrit të pranimeve të studentëve, kjo lidhur me tarifat relativisht të larta të shkollimit për ambientin shqiptar dhe duke marrë në konsideratë dhe krizën ekonomike e mungesën e të ardhurave të mjaftueshme të prindërve për të shkolluar fëmijët e tyre;
4. Kostot e shërbimeve mund të rriten, gjë e cila mund të reflektohet dhe në rritjen e tarifave që u duhet të paguajnë studentët.

Rekomandime

Sektori i arsimit të lartë në Shqipëri këto vitet e fundit ka pësuar dhe po pëson ndryshime të mëdha, është një sektor ku konkurenca është mjaft e madhe, dhe nga praktika e rajonit dhe ajo botërore rezulton që jo të gjitha universitetet do të mbijetojnë dhe konkurojnë me sukses në dekadat e ardhshme. Prandaj, për UMSH del një detyrë e rëndësishme për hartimin e planeve afatgjata 10-20 vjeçare për të parashikuar ndryshimet e ndryshme që mund të ndodhin përsa i përket profesioneve të reja që krijohen dhe të atyre që mund të dalin 'jashtë loje', dhe përshtatjen e programeve të studimit dhe kurrikulave sipas ndryshimeve eventuale në të ardhmen. Për të qenë një institucion arsimor sa më konkurrues, theksi duhet vënë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, element i cili përdoret fuqishëm nga mjaft universitete me emër në rajon e më gjerë.

Në bazë të analizës së bërë në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe situacionit të plotësimit të standardeve për akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë MP në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike, jemi të mendimit se UMSH ka bërë përpjekje të mëdha për të arritur standarde të larta të programeve të studimit dhe të zbatimit të tyre në funksion të arritjes së misionit dhe vizionit të përcaktuar në planin strategjik të saj.

Në analizën SWOT të bërë më lart, ndër *pikat e forta* të UMSH mund të përmendim: Të paturit e pedagogëve me tituj e grada shkencore dhe me eksperiencë të madhe në mësimdhënie; Programe dhe kurrikula bashkëkohore në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në Shqipëri dhe në përputhje me kërkesat e tregut vendas dhe atij të huaj; Theksi i vazhdueshëm në punën kerkimore-shkencore duke i nxitur pedagogët të marrin pjesë në konferenca me artikuj të përgatitur nga ata për çështje që janë mjaft të rëndësishme për aktualitetin në Shqipëri dhe për të ardhmen e saj; Një nga infrastrukturat më moderne dhe më të mira në Shqipëri duke përfshirë godinën, klasat, laboratorët, sallat optimale të leksioneve dhe seminareve, kushtet optimale me ngrohje e ftohje, mundësia e përdorimit të teknologjisë së informacionit; Bashkëpunimet me institucione brenda vendit dhe universitete të huaja; Shërbimet e tjera që ofron UMSH për pedagogët e studentët të tilla si bibliotekë me tekste në gjuhën shqipe dhe të huaj, aksesin në përdorimin e internetit si nga pedagogët, ashtu dhe studentët etj.

Lidhur me *mundësitë* që i shfaqen UMSH në të ardhmen mund të përmendim: Zgjerimi i bashkëpunimeve brenda dhe jashtë vendit, në drejtim të kërkimit shkencor dhe shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve; Imazhi publik i UMSH që synohet të rritet më shumë në të ardhmen kjo e siguar nga profili publik i drejtuesit/esve më të lartë të saj; Motivimi i lartë i pedagogëve dhe personelit administrativ e ndihmës; dhe Burimet financiare që sipas drejtuesit/esve, ky element do t'i shërbejë UMSH për ta shndërruar në fuqi në të ardhmen.

Lidhur me programet e studimit që janë subjekt i akreditimit: programin e studimit të ciklit të dytë MP në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike jepen *sugjerimet* e mëposhtme:

1. Të shikohet në të ardhmen te UMSH mundësia e rritjes së numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe me grada e tituj shkencore sepse kjo gjë do ta ndihmonte atë të plotësonte standardet lidhur me numrin e pedagogëve me kohë të plotë e të krijonte një profil të plotë të sajin (aktualisht nuk e plotëson këtë standard; problem nga i cili vuajnë shumica dërrmuese e universiteteve private në Shqipëri);
2. Duhet vënë theksi në përmirësimin dhe azhornimin e vazhdueshëm të programeve të këtyre profileve duke u bazuar në literaturat më bashkëkohore dhe të autorëve të njohur të vendit dhe botërorë;
3. Të bëhet shumë promovim për tërheqjen në këto profile studimi të studentëve të rinj me rezultate të larta nga sistemi i studimeve Bachelor, me qëllim që të investohet shumë tek ata dhe të bëhen në të ardhmen lidera përkatësisht në fushat e administrim biznesit dhe të administratës publike;
4. Për MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike, të shihet mundësia që në semestrin e dytë të studimeve master të përfshihen të paktën dy lëndë me zgjedhje, praktikë e hasur në shumë universitete të njohura botërore;
5. Të hartojë një plan të përgjithshëm strategjik 10-20 vjeçar, dhe i detajuar në periudha afatmesme e afatshkurtra për zhvillimin e institucionit dhe për të parashikuar ndryshimet e ndryshme që mund të ndodhin e për t'i bërë ballë konkurrencës së vazhdueshme nga universitete të tjera të vendit qofshin këto publike apo private.

Si përfundim, pasi kemi shqyrtuar, analizuar dhe vlerësuar: cilësinë e programeve të studimit të ciklit të dytë MP në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike; hartimin, zbatimin e standardeve të cilësisë dhe përpjekjet e vazhdueshme për cilësi të lartë e të qëndrueshme; gjendjen aktuale të institucionit të arsimit të lartë jo publik "Universiteti Mesdhetar të Shqipërisë"; stafin e kualifikuar mësimdhënës, të kombinuar me infrastrukturën dhe teknologjinë bashkëkohore që UMSH ofron; konstatoj se institucioni i arsimit të lartë jo publik UMSH ka plotësuar pjesën dërrmuese të standardeve dhe kriterëve përkatëse (ato pak që nuk i plotëson, t'i lihen si detyra për t'i përmirësuar në të ardhmen e afërt apo të mesme), prandaj i rekomandojmë APAAL_{it} dhe KA_{së} që lidhur me institucionin e arsimit të lartë jo publik Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) të shohë pozitivisht mundësinë e akreditimit për programet e studimit ciklit të dytë MP në Administrim Biznesi dhe MP Shkenca Politike dhe Administrative, me profil Administratë Publike.

Eksperti i Vlerësimit të Jashtëm

Doc. Dr. Arjan QEFALIA

Tiranë, 10 maj 2012